



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 931/2021

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, i përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Kymete Kica dhe Adnan Konushevcu anëtarë, duke vendosur përkritazi me apelin e Ylber Gjocaj, kandidatë për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Deçanit, nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Deçan, paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur me datë 07.11.2021, mori këtë:

## V E N D I M

**REFUZOHET** i pabazuar apeli Anr.931/2021 i datës 04.11.2021 i parashtruar nga Ylber Gjocaj, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Deçanit, nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dega në Deçan, paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, me të cilin ka kërkuar rinumërimin e votave.

## A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datën 04.11.2021, nga Ylber Gjocaj, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Deçanit, nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dega në Deçan, me të cilën pretendon se në bazë të raportimeve të komisionerëve mbi saktësinë e votës vërehet mospërputhje e madhe e rezultateve të plotësuara në Formularët e Rezultateve për Kandidat-FRK, tjetërsim i vullnetit të votuesve duke u falsifikuar rezultatet. Sipas parashtruesit të apelit këto parregullësi kanë ndodhur në vendvotimet: 0106c/01R, 0102c/02R dhe 0111c/03D. Parashtruesi i apelit nuk ka bashkangjitur asnjë provë, si dëshmi lidhur me pretendimet në apel.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të besueshmërisë së apelit dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

### Apeli është i pabazuar

Paneli, vlerëson se parashtruesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar asnjë dëshmi lidhur me shkeljet e supozuara për mospërputhje të rezultateve, tjetërsim të votës si dhe falsifikim të rezultateve edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret, paneli, nuk mundi të konstatoj se ka

pasur mos përfshirje të votave apo manipulime të votave të parashtruesit të apelit gjatë regjistrimit të votave, për faktin se thëniet e tij nuk mbështeten në asnjë provë konkrete por janë të përgjithshme e jo të konkretizuara, sepse pritjet e ankuesit për të marrë më shumë vota automatikisht nuk nënkupton se ka mos përfshirje të saktë votave në rezultate përfundimtare, andaj pala ankuese nuk i ka argumentuar shkeljet e pretenduara në apel.

Si përfundim, Paneli vlerësoi se apeli i Ylber Gjocaj, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Deçanit, nga subjekti politik LVV dega në Deçan, nuk është bazuar në dëshmi të qarta dhe bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje gjatë numërimit apo regjistrimit të votave për kandidat, andaj kërkesa e apellesit për të rinumëruar të gjitha fletëvotimet e kandidatëve për kuvend komunal në vendvotimet e lartcekura, vlerësohet si i pa bazuar.

Andaj, Paneli vlerësoi se apeli parashtruar nga kandidati Ylber Gjocaj nga Subjektit Politik LVV, dega në Deçan nuk është i bazuar me asnjë dëshmi ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje apo parregullsi gjatë numërimit të votave.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr.931/2021 më datën 07.11.2021



**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.